



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

SENATI AKADEMIK

Nr. 154 prot.

Shkodër, më 23.04 2026

V E N D I M

Nr. 126, datë 23.04 2026

**"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR.302, DATË
20.11.2025 "PËR MIRATIMIN E DISA PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT
PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027"**

Në mbështetje të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 2, germa b); neni 35, pika 1; neni 38, pika 1; Statutit të USH-së, neni 17, pika 6, germa f); Vendimit nr.302, datë 20.11.2025 të SA-së "Për miratimin e disa programeve të reja të studimit për vitin akademik 2026-2027"; Shkresës së Fakultetit të Shkencave të Edukimit nr.331 prot., datë 22.04.2026, regjistruar në Rektorat me nr.1535 prot, datë 22.04.2026, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 23.04.2026,

VENDOSI:

1. Të ndryshojë emërtimin e programit të studimit nga Master i Shkencave në "Psikologji ligjore dhe kriminologji klinike" në Master i Shkencave në "Psikologji Ligjore".
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit.
3. Pas miratimit nga BA, vendimet i përcillet Ministrisë së Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. dr. Tonin G. JURAJ

Nr: 1535 Prot

dt: 22.04.26



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Fakulteti i Shkencave të Edukimit

Dekani

Nr. 331 prot.

Shkodër, më 22.04.2026

Lënda: Dergim i kërkesës së Departamentit të Psikologji-Punë Sociale për shqyrtim dhe miratim të riemërimit të programit të studimit.

SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË SHKODRË

Bashkëngjitur po ju dërgojmë kërkesën e Departamentit të Psikologji-Punë Sociale për shqyrtim dhe miratim të riemërimit të programit të studimit.

Prof. As. Dr. **Eranda Kalluni (Bilali)**





550
22.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË DHE PUNËS SOCIALE

Nr. 33 Prot

Shkodër, më 22 . 04 .2026

Lënda: Kërkesë për shqyrtim dhe miratim të riemërtimit të programit të studimit

Drejtuar: SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË SHKODRËS

Në vijim të shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nr. 2724 Prot., datë 08.04.2026, mbi vlerësimin e aplikimit për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave", Ministria ka përfunduar shqyrtimin paraprak të aplikimit të paraqitur nga Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" për programin "Psikologji Ligjore dhe Kriminologji Klinike", për vitin akademik 2026-2027.

Në shkresën përkatëse, Ministria sugjeron riformulimin e emërtimit të programit të studimit.

Për sa më sipër, duke qenë se ndryshimi i emërtimit të programit kërkon miratimin e organeve kolegjiale të universitetit, kërkojmë nga Senati Akademik shqyrtimin dhe miratimin e riemërtimit të programit nga:

"Master i Shkencave në Psikologji Ligjore dhe Kriminologji Klinike"

në:

"Master i Shkencave në Psikologji Ligjore."

Miratimi i këtij ndryshimi është i nevojshëm për vijimin e procedurave të aplikimit pranë Ministrisë brenda afateve të përcaktuara.

Me respekt,

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT

Dr. Elona Hasmujaj

EH